



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 735/6 prot.

Tiranë, më 22.09.2021

**VENDIM**

**Nr. 115, datë 22.09.2021**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT  
TË KOMISIONERIT NR. 100, DATË 13.07.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 100, datë 13.07.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ nisur me Urdhrin nr.50, datë 07.07.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, Për verifikimin e informacionit të marrë nëpërmjet medias, i publikuar në emisionin investigativ “Fiks Fare”, i transmetuar në datën 06.07.21 në kanalën televiziv kombëtar “Top Channel”, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë të emërimit të punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Administrative”, pranë Bashkisë Kukës.

**KONSTATOVA SE:**

Në emisionin investigativ “Fiks Fare”, të datës 06.07.2021, të publikuar në televizionin kombëtar “Top-Channel”, është ngritur pretendimi se, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Administrative, pranë Bashkisë Kukës, është emëruar në këtë pozicion në kundërshtim me ligjin, pasi rezulton që të jetë i dënuar penalisht me dy vendime të formës së prerë nga gjykata, për kryerjen e disa veprave penale.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Kukës të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 100, datë 13.07.2021, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ nisur me Urdhrin nr.50, datë 07.07.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, Për verifikimin e informacionit të marrë nëpërmjet medias, i publikuar në emisionin investigativ “Fiks Fare”, i transmetuar në datën 06.07.21 në kanalën televiziv kombëtar “Top Channel”, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë të emërimit të punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Administrative”*, pranë Bashkisë Kukës.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Kukës ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrës të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.100, datë 13.07.2021, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Bashkia Kukës, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Konkretisht, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kukës për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, të veprojë sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr.100, datë 13.07.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Vërej se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 100, datë 13.07.2021, Bashkia Kukës me urdhrin nr.401, datë 15.07.2021 ka urdhëruar lirimin nga detyra të punonjësit \*\*\*\*\* nga pozicioni Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Administrative.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 100, datë 13.07.2021, të Komisionerit, *““Mbi përfundimin e hetimit administrativ nisur me Urdhrin nr.50, datë 07.07.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, Për verifikimin e informacionit të marrë nëpërmjet medias, i publikuar në emisionin investigativ “Fiks Fare”, i transmetuar në datën 06.07.21 në kanalën televiziv kombëtar “Top Channel”, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë të emërimit të punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin e*

*punës, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Administrative”, pranë Bashkisë Kukës.*

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit së Bashkisë Kukës, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.100, datë 13.07.2021.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kukës dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**